



VENDIMI dhe GJETJET

Data e miratimit: 12 nëntor 2014

Numri i lëndës: 2013-03

Goran Becic

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 12 nëntor 2014, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit, siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar në Panel më 27 maj 2013.
2. Më 7 qershor 2013, Paneli ka vendosur të njoftoj shefin e Misionit (ShM) të EULEX-it në Kosovë rreth ankesës, duke e ftuar atë që të

parashtrajtje vërejtjet me shkrim rreth ankesës. Vërejtjet ishin pranuar në 15 gusht 2013. Më pas ato i janë komunikuar ankuesit për komente. Ankuesi i ka ofruar komentet e tij më 8 shtator 2013 dhe ka dërguar komente shtesë më 12 shtator 2013. Këto komente janë përkthyer dhe i janë dërguar ShM për informim më 10 tetor 2013.

3. Më 27 nëntor 2013, Paneli ka vendosur që t'i komunikoj ShM një deklaratë të zgjeruar të fakteve, duke e ftuar atë të paraqesë vërejtje shtesë me shkrim. Më 9 dhjetor 2013, ankuesi ka njoftuar Panelin rreth zhvillimeve të mëtejshme në lëndën e tij. Më 26 dhjetor 2013, ShM ka dorëzuar vërejtje të tjera. Ankuesi ka dorëzuar komente të tjera më 9 shkurt 2014 dhe më 27 maj 2014.
4. Më 1 korrik 2014, Paneli ka shpallur ankesën të pranueshme dhe ka gjetur, se në bazë të parashtrimeve të palëve, ankesa ka ngritur çështje serioze të fakteve dhe ligjit që kanë të bëjnë me shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut në lidhje me nenet 13 dhe 14 të Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), si dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ, për vendosjen e të cilave kërkohet të bëhet shqyrtimi i bazueshmërisë së ankesës.
5. Më 21 korrik 2014 ankuesi ka paraqitur vërejtjet e mëtejshme lidhur me lëndën. Më 30 shtator 2014 ShM ka dërguar komente shtesë për faktet, si dhe për bazueshmërinë e lëndës. Më 16 tetor 2014, ankuesi ka parashtruar komentet e fundit për këtë lëndë.

II. FAKTET

6. Ankuesi posedon një banesë në Prishtinë. Ankuesi pohon se që nga viti 1999 nuk ka qenë në gjendje të merr posedimin e banesës së tij. Në vitin 2004, njëfarë S.H., i cili banonte në mënyrë të paligjshme në atë banesë ishte dëbuar prej banesës në bazë të një "Vendimi nga Habitati [Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore] (HPCC/D/87/2003/C i datës 29.08.2003) përmes së cilit është konfirmuar se [ankuesi është] pronar legjitim i banesës".
7. Pavarësisht prej këtij vendim, ankuesi nuk ka arritur të rimarrë në posedim banesën e tij. Në disa raste, uzurpatorë të ndryshëm kishin zënë banesën e tij dhe më pas e kishin braktisur atë.
8. Në vitin 2009, gjatë një periudhe të shkurtë kohore kur banesa kishte mbetur e lirë, ankuesi kishin arritur ta rinovonte atë.
9. Më 26 gusht 2009, gruaja e ankuesit kishte shkuar në banesë dhe kishte zbuluar se përsëri banesa ishte e zënë në mënyrë të paligjshme. Me atë rast, dera e banesës dyshohet se ishte hapur nga vajza e një R.Q., e cila ka thënë se kjo banesë ju ishte "ndarë" R.Q.-së nga pjesëtarët e stacionit policor nr. 4 "Dardania" në Prishtinë. Ankuesi pohon se zyrtarët policorë nga stacioni policor nr. 4 ja kishte lëshuar me qira banesën R.Q.-së.

10. Ankuesi pohon se R.Q. është pjesëtar i policisë së Kosovës dhe ai e kishte marrë në posedim banesën me miratimin e shefit të stacionit policor nr. 4.
11. Më 14 shtator 2009, përfaqësuar nga një avokat i "Këshillit danez për refugjatë", ankuesi kishte ngritur padi penale në prokurorinë publike komunale në Prishtinë kundër R.Q. dhe pjesëtarëve të PK-së të stacionit policor nr. 4. Më pas, ankesa ishte përfaqësuar nga avokatët e OJQ-së: "Mbështetje e mëtejshme për refugjatët dhe personat e zhvendosur brenda vendit në Serbi". Ankuesi ka pohuar se më 6 nëntor 2009, prokurori publik kishte kërkuar nga policia të mbledh informata për ta identifikuar kryesin e veprës penale.
12. Ankuesi pohon se e ka kontaktuar EULEX-in përmes postës elektronike më 29 nëntor 2009 dhe e ka njoftuar atë lidhur me rastin e tij. Ai ishte referuar tek një pjesëtar i personelit të EULEX-it (M.M.) dhe ishte njoftuar se ankesa e tij ishte dërguar tek disa njësi në kuadër të misionit të EULEX-it. Më 13 dhjetor 2009, ankuesi ka njoftuar M.M. lidhur me lëndën e tij dhe në mënyrë të veçantë lidhur me katër përpjekje të tij për të raportuar çështjen në polici (më 4 qershor 2008, 14 tetor 2008, 26 gusht 2009 dhe 10 tetor 2009), të cilat nuk kanë dhënë asnjë rezultat. Më 5 janar 2010, ankuesi ka marrë një përgjigje nga M.M., i cili i ka ofruar atij të dhënat e personit kontaktues, pra shefit të zyrës ndërlidhëse të gjykatës në Mitrovicë, duke i sugjeruar që ta kontaktoj atë.
13. Ankuesi ka paraqitur postën elektronike nga M.M., ku thuhet *ndër të tjera se "EULEX-i është i interesuar në rastet e keqpërdorimeve eventuale në sistemin e gjykatës dhe është në kuadër të mandatit tonë për të përmirësuar mbrojtjen e qytetarëve dhe të drejtat e tyre para gjykatave"*. Ankuesi është këshilluar që të kontaktoj shefin e zyrës ndërlidhëse të gjykatës në Mitrovicë pasi: *"vlerësimi i saj lidhur me nevojën që EULEX-i të ndërhyjë mund të jetë vendimtar"*.
14. Përpjekjet e mëtejshme nga ana e ankuesit për t'ju drejtuar zyrtarit të sugjeruar si dhe kontaktit fillestar brenda EULEX-it, nuk kanë dhënë asnjë përgjigje.
15. EULEX pohon se M.M ka punuar si zyrtar politik dhe raportues deri në verë të vitit 2011, kur ai kishte dhënë dorëheqjen nga misioni. EULEX-i më tej pohon se nuk ka qenë në gjendje të konfirmojë secilin regjistrim të ankesave nga ankuesi apo komunikimeve të tjera në mes të tij dhe EULEX-it gjatë vitit 2010.
16. Më në fund, më 6 maj 2010, ankuesi ka qenë në gjendje të paraqesë një ankesë në stacionin policor nr. 4 me ndihmën e një avokati.
17. Pretendohet se më 30 gusht 2010, ankuesi ka parashtruar një letër në zyrën e prokurorisë publike komunale duke kërkuar që autoritetet

duhet të ndërmarrin masa në lidhje me rastin e tij dhe duhet t'i përgjigjet me shkrim. Ankuesi thekson se nuk ka marrë përgjigje.

18. Më 29 qershor 2011, prokurori publik i Kosovës ka ngritur aktakuzë kundër R.Q.
19. Pas kësaj, ankuesi ka kontaktuar prapë EULEX-in përmes postës elektronike në fillim të janarit 2012. EULEX-i pranon se një komunikim nga ankuesi tek EULEX-i ishte regjistruar në fund të vitit 2011. EULEX-i më tej pohon se ky ishte komunikimi i parë i regjistruar me ankuesin. Më 16 janar 2012, bashkërenduesi i EULEX-it për të Drejtat Pronësore ishte përgjigjur ankuesit për herë të parë. Më 14 shkurt 2014, bashkërenduesi i EULEX-it për të Drejtat Pronësore edhe një herë i ka shkruar ankuesit. Në lidhje me këtë, ankuesi i ka paraqitur Panelit një letër përgjigje nga bashkërenduesi për të Drejtat mbi Pronë të EULEX-it të datës 14 shkurt 2012, ku e këshillon atë në lidhje me mjetet juridike në dispozicion. Më tej, është treguar se përgjigja ju ishte shpërndarë organit të duhur të EULEX-it që është përgjegjës për sigurimin e mbështetjes ndaj zyrës së prokurorisë komunale në Prishtinë, shefit të zyrës së prokurorisë publike komunale në Prishtinë, si dhe ushtruesit të detyrës së drejtorit të zyrës së këshillit disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
20. EULEX pohon se më 24 shkurt 2012, Zyra e Këshillit Disiplinor i ka shkruar një letër përmes postës elektronike ankuesit duke kërkuar nga ai hollësi rreth lëndës së tij.
21. Ankuesi ka paraqitur një letër të datës 7 mars 2012 që e ka marrë nga Zyra e Këshillit Disiplinor, ku e informon atë se prokurori i parë i caktuar për këtë rast ishin zëvendësuar në vitin 2010 dhe se më 28 shkurt 2012, çështja i ishte dhënë një tjetër prokurori, i cili ka kërkuar nga polica që të grumbullonte informata. Ankuesi pohon se nuk ka pasur asnjë përparim në lëndën e tij.
22. Më 30 gusht 2012, ankuesi përsëri iu drejtuar bashkërenduesit të EULEX-it për të Drejtat Pronësore, duke kërkuar nga ai ndihmë. Ankuesi ka marrë një përgjigje nga bashkërenduesi i EULEX-it për të Drejtat Pronësore më 20 shtator 2012, duke i ofruar këshilla mbi mjetet e mundshme dhe duke e informuar atë se rasti iu ishte drejtuar autoritetit përgjegjës të EULEX-it për qëllime informative.
23. Më 12 shtator 2012, prokuroria komunale e Prishtinës ka zhvilluar një intervistë me R.Q., i cili dyshohej që ka pranuar se ishte duke e shfrytëzuar banesën, ku në mënyrë të jashtëligjshme kishte hyrë pasi ja kishte thyer derën.
24. Më 28 janar 2013, ankuesi edhe një herë iu ka drejtuar EULEX-it, pasi gjoja se atij iu ishte kërkuar nga R.Q. t'i paguante atij 5.000 euro si parakusht që ai të lironte banesën. Ankuesi nuk ka marrë asnjë përgjigje nga EULEX-i.

25. Më 1 prill 2013, përfaqësuesi ligjor i ankuesit i ka shkruar zyrës së prokurorisë themelore publike dhe i ka kërkuar që të nis procedurat penale në bazë të fakteve të mbledhura dhe pranimit nga ana e R.Q. Ai nuk ka pranuar asnjë përgjigje.
26. Më 16 Maj 2013, lënda i ishte caktuar një gjykatësi të vetëm nga departamenti i përgjithshëm i Gjykatës Themelore të Prishtinës.
27. Më 15 gusht 2013, ankuesi ka marrë një letër nga zyra e prokurorisë themelore të Prishtinës. Atij iu ishte kërkuar që ta plotësoj lëndën e tij me dokumente shtesë, duke përfshirë edhe dëshminë e pronësisë së banesës. Më tej, atij iu ishte kërkuar të paraqesë vendimin e komisionit për kërkesa pronësore banesore (shih par. 6 më lartë). Ankuesi ka siguruar dokumentet përkatëse dhe më tej ka deklaruar se tashmë i kishte paraqitur këto dokumente atëherë kur kishte paraqitur padinë penale lidhur me këtë lëndë.
28. Më 16 dhjetor 2013, ankuesi ka marrë një përgjigje nga zyra e këshillit disiplinor në lidhje me një kërkesë nga ankuesi, i cili ka deklaruar se lënda kundër R.Q. (propozim për aktakuzë) ishte dorëzuar nga Prokuroria Komunale në Gjykatën Komunale në Prishtinë me 5 korrik 2011 dhe ajo ishte në pritje pranë kësaj gjykate. Më tej, zyra e këshillit disiplinor nuk ka përcaktuar asnjë bazë për nisjen e hetimeve disiplinore ndaj sjelljes joprofesionale prokuroriale të prokurorit në lëndën e R.Q. Ankuesi ishte informuar nga Zyra e Këshillit Disiplinor se gjyqtari përkatës në rastin e tij nuk ka vendosur ende për konfirmimin e aktakuzës (shih par. 18 më lartë).
29. Në një datë të papërcaktuar gjatë vjeshtës së vitit 2013, ekipi mobil në çështjet e gjyqësorit nga divizioni i përforcimit të EULEX-it ka marrë përsipër monitorimin e procedurës penale, e cila ishte në pritje pranë gjykatës themelore në Prishtinë.
30. Më 4 tetor 2013, gjykatësi ka lëshuar për herë të tretë thirrjen për R.Q., pasi që ai dy herë nuk ishte paraqitur në seancat gjyqësore.
31. Më 28 tetor 2013, i akuzuar R.Q. më në fund ishte paraqitur në seancë. R.Q. ka kërkuar përkthimin në gjuhën serbe siç pretendonte ai se nuk ishte i rrjedhshëm në gjuhën shqipe për shkak të përkatësisë së tij gorane. Gjykatësi ka shtyrë seancën për 29 nëntor 2013 për të vendosur rreth bazueshmërisë së lëndës, në të cilën i akuzuari R.Q. përsëri nuk ishte paraqitur.
32. Më 16 dhjetor 2013, gjyqtari i Gjykatës Themelore ka gjetur të akuzuarin fajtor dhe i ka ngarkuar atij një dënim me kusht prej tre muajsh burgim, ndërsa gjithashtu ka urdhëruar atë ta lironte pronën brenda 30 ditëve nga data e gjykimit.
33. Më 21 korrik 2014, ankuesi ka pohuar se kishte zbuluar më 20 korrik 2014 se banesa e tij ishte thyer më 20 korrik 2014 dhe iu ishte

uzurpuar përsëri. Uzurpator i ri dyshohej të jetë i përkatësisë etnike shqiptare dhe kishte ndërruar derën e hyrjes, përfshirë edhe bravën.

34. Më 1 gusht 2014, përfaqësuesi ligjor i ankuesit ka ngritur një akuzë penale kundër ri-uzurpimit të banesës së tij. Më 15 tetor 2014, ankuesi i ka dërguar një porosi përmes postës elektronike EULEX-it dhe ka kërkuar që prokurorët e EULEX-it të marrë përsipër lëndën e tij.

Ankesat

35. Ankuesi pohon se EULEX-i nuk ka arritur të reagojë në mënyrë të duhur lidhur me lëndën e tij dhe prandaj ka shkelur të drejtat e tij të njeriut. Mund të nxjerrët se ankuesi ankohet në bazë të nenit 1 të protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNj) në lidhje me nenin 14 të Konventës dhe në bazë të nenit 13 të Konventës.

IV. LIGJI

36. Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë KEDNj dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (KEDCP), të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga organet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.

LIGJI PËRKATËS NË FUQI

Veprimi i përbashkët

37. Pjesët përkatëse të nenit 2 dhe 3 të veprimit të përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008 rreth Misionit Evropian mbi Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i KOSOVË (më tutje si: Veprimi i Përbashkët), vijon si më poshtë:

Neni 2 Deklarata e Misionit

EULEX-i Kosovë do t'i ndihmojë institucionet e Kosovës, organet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në përparimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies dhe në zhvillimin dhe forcimin e një sistemi të pavarur shumë-etnik të drejtësisë, policisë dhe shërbimit doganor, duke siguruar se këto institucione nuk iu nënshtrohen ndërhyrjeve politike dhe përfillin standardet e njohura ndërkombëtare dhe praktikat më të mira evropiane.

EULEX-i KOSOVË, në bashkëpunim të plotë me Programin për Ndihmë të Komisionit Evropian, do ta përmbushë mandatin e tij përmes monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit, duke ruajtur përgjegjësi të caktuara ekzekutive.

Neni 3

Detyrat

Në mënyrë që të përmbushet Deklarata e Misionit e përcaktuar në nenin 2, EULEX-i Kosovë do të:

(d) të sigurojë që rastet e krimeve të luftës, terrorizmit, krimit të organizuar, korrupsionit, krimit ndëretnik, krimit financiar/ekonomik dhe krimeve tjera të rënda të hetohen, ndiqen, gjykohen dhe zbatohen siç duhet, sipas ligjit në fuqi, përfshirë, kur është e përshtatshme, nga hetues, prokurorë dhe gjykatës ndërkombëtarë së bashku me hetues, prokurorë dhe gjykatës të Kosovës ose në mënyrë të pavarur dhe përmes masave duke përfshirë, nëse ka nevojë, krijimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të strukturave ndërmjet autoriteteve policore dhe të prokurorisë;

Ligji mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjykatësve dhe prokurorëve 2008/03-L053, në fuqi deri më 31 maj 2014 (më tutje si: Ligji mbi kompetencat)

Neni 6

6.1 Bashkërenduesi i EULEX-it për të Drejtat Pronësore në Kosovë do të ndihmojë në bashkërendimin e çështjeve lidhur me të drejtat pronësore, si dhe zgjidhjen e kërkesave ndërmjet palëve të përfshira në këtë çështje, duke përfshirë por jo kufizuar në Agjencinë Kosovare të Pronës, Komisionin Kosovar për Kërkesa Pronësore, Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, gjykatat e rregullta, apo Shërbimin Policor të Kosovës.

6.2 Të gjitha palët që merren me çështjet e të drejtave pronësore, përfshirë këtu zgjidhjen e kërkesave në Kosovë, janë të obliguar që t'i ofrojnë falas bashkërenduesit të EULEX-it për të Drejtat Pronësore çdo informatë të kërkuar nga ta dhe t'i lejojnë qasje në të gjitha elementet e nevojshme për zbatimin e mandatit të vet.

Neni 11

Kompetencat e prokurorëve të EULEX-it për krimet e motivuara nga urrejtja

11.1 Në çdo kohë gjatë procedurës dhe në pajtim me kryeprokurorin e EULEX-it, prokurorët e EULEX-it mund të marrin përgjegjësi për çdo hetim a ndjekje penale të çdo veprë penale, përfshirë këtu veprat penale kundër personave apo pronës, ku viktima, prona apo objekti i veprës penale duken të jenë përzgjedhur për shkak të lidhjes, bashkimit, afërsisë, mbështetjes apo anëtarësisë së tyre të vërtetë apo të perceptuar me një grup të vërtetë apo të perceptuar të identifikuar sipas racës, origjinës kombëtare, etnike apo shoqërore, afërsisë me ndonjë pakicë kombëtare apo grup politik, gjuhës, ngjyrës, besimit, gjinisë, moshës, të metave fizike apo mentale, orientimit seksual, apo faktorëve tjerë të ngjashëm.

Neni 12

Kompetencat e prokurorëve të EULEX-it në rast të mosgatishmërisë apo paaftësisë së prokurorëve publik të Kosovës

12.1 Në çdo fazë të secilës procedurë penale, nëse një prokuror publik i Kosovës nuk është i gatshëm apo është i paaftë që të ushtrojë detyrat e tij dhe kjo mosgatishmëri apo paaftësi mund të rrezikojë hetimin apo ndjekjen e duhur të një vepre penale, apo kurdoherë që ekziston dyshimi i bazuar se bëhen përpjekje për të ndikuar në hetimin apo ndjekjen e një vepre penale, kryeprokurori i EULEX-it ka kompetencë që të kërkojë nga kryeprokurori i zyrës kompetente që atë lëndë t'ia caktojë:

- a) një prokurori tjetër publik të Kosovës që punon në të njëjtën zyre prokuroriale,
- b) apo cilitdo prokuror të EULEX-it që do të marrë përgjegjësinë për hetimin apo ndjekjen penale përkatëse.

38. Paneli përsërit se në vendimin e tij të pranueshmërisë së ankesës, Paneli kishte konstatuar se lënda duhet të shqyrtohet në bazë të neneve 13 dhe 14 të KEDNj-së, si dhe nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së (shih 2013-03, [Becic kundër EULEX-it](#), 1 korrik 2014, në par. 53,).

IV. PARASHTRESAT NGA PALËT

Parashtresat e EULEX-it lidhur me bazueshmërinë e lëndës

39. Në parashtrimin e tij të datës 30 shtator 2014, EULEX-i përsërit argumentin e vet se pretendimi i ankuesit nuk ka vërtetuar se në rastin e tij ishte kryer ndonjë krim i motivuar mbi baza të urrejtjes apo baza ndëretnike, që mund t'i mundësojë që sipas mekanizmit të paraparë në nenin 11 të ligjit mbi kompetencat, e cila i ofron mundësinë prokurorëve të EULEX-it për të marrë lëndën përsipër. Më tej, EULEX-i pohon se vepra që shkel paprekshmërinë e banimit sipas nenit 166 par. 1 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, e cila është subjekt i ankesave, nuk bie në kompetencë të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it.
40. Për çështjet e të drejtave pronësore, EULEX ka pasur një bashkërendues për të Drejtat Pronësore, i cili ka qenë në kontakt me ankuesin.
41. EULEX pohon se në mënyrë që të kualifikohet si krim i motivuar mbi bazën e urrejtjes, vepra/sjellja duhet të ishte kryer mbi motivin e bazuar në paragjykime ndëretnike. Është pohuar se përkundër faktit që ankuesi i përket pakicës etnike serbe të Kosovës dhe personi i dënuar për uzurpimin e paligjshëm të pronës së tij i takon një etniteti tjetër, konkretisht një grupi pakicë goran, nuk ka asgjë në lidhje me rastin që do të tregonte se R.Q. ka zgjedhur pronën e ankuesit si objekt për shkak të origjinës etnike të ankuesit. Duket se R.Q. ka uzurpuar pronën për arsye të thjeshtë se ajo ishte e zbrazët.
42. EULEX pohon se edhe nëse supozohet se krimi do të binte në kuadër të kategorisë së krimeve mbi bazën e motivit të urrejtjes, neni 11 i ligjit mbi kompetencat në fuqi në kohën e ndodhjeve nuk përfshinë ndonjë

obligim përbërës mbi prokurorët e EULEX-it për të vepruar, por mundësinë për ta bërë këtë. Në këtë rast të veçantë, prokurorët e EULEX-it nuk kanë qenë të informuar për lëndën, pasi ajo bie jashtë mandatit të tyre dhe korrespondenca e ankuesit me bashkërenduesin e EULEX-it për të Drejtat Pronësore nuk i ishte dërguar në mënyrë të veçantë prokurorëve të EULEX-it. Më tej, është pohuar se për shkak të burimeve të kufizuara dhe numrit të madh të lëndëve që tashmë hyjnë në kuadër të mandatit ekzekutiv të prokurorit të EULEX-it, është e pamundur për prokurorët e EULEX-it të veprojnë ndaj çdo lënde të mundshëm që mund të hyjë në kuadër të mandatit të tyre.

43. Më tej, është pohuar se neni 12 i ligjit mbi kompetencat ofron një mundësi të thjeshtë për të reaguuar nga kryeprokurori i EULEX-it. Për shkak të faktit se prokurori vendor tashmë e kishte paraqitur një padi më 29 qershor 2011 (shih par 18.), duket se prokurori vendor ishte i gatshëm dhe në gjendje për të vazhduar me lëndën, gjithashtu nëse nuk ka qenë e qartë atëherë pse lënda nuk i ishte caktuar një gjykatësi të vetëm deri më datën 16 maj 2013. Prandaj, as neni 12 i ligjit mbi kompetencat nuk është i zbatueshëm.
44. Procedura penale në rastin e ankuesit janë zhvilluar gjatë vjeshtës së vitit 2013 dhe R.Q. ishte urdhëruar ta lironte banesën. Prandaj, ankuesi kishte pasur qasje në gjykatë dhe kishte një mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të KEDNj-së dhe në lidhje me nenin 1 të protokollit 1 të Konventës së njëjtë. EULEX pohon se përkundër disa vonesave në procedurë, nuk ka asnjë tregues se ankuesi mund të ishte i diskriminuar për shkak të etnisë së tij në gëzimin e të drejtave të tij të pronësisë.
45. EULEX-i pohon se ju ishte përgjigjur me kohë korrespondencës së ankuesit pa diskriminim dhe ka siguruar edhe monitorimin e lëndës së tij në pajtim me mandatin e vet. Kohëzgjatja e procedurës nuk mund të konsiderohet si e tepërt dhe vonesat nuk i ngarkohen EULEX-it.
46. EULEX-i më tej pohon se ka ofruar në mënyrë efektive mjetin korigjues në dispozicion të EULEX-it në çështjet pronësore nëpërmjet bashkërenduesit të EULEX-it për të Drejtat Pronësore, siç parashihet me nenin 6 të ligjit mbi kompetencat, duke iu përgjigjur ankuesit në kohën e duhur, duke i ofruar atij këshilla dhe duke i përcjellë ankesat e tij tek autoritetet kompetente vendore.

Vërejtjet e ankuesit

47. Më 21 korrik 2014, ankuesi ka paraqitur komente shtesë në reagim ndaj vendimit të pranueshmërisë të Panelit. Është deklaruar se ai nuk ka pasur qasje në banesën e tij që nga viti 1999, e cila tashmë është e dëmtuar rëndë. Ai pohon se ka qenë i kërcënuar vazhdimisht nga uzurpatorët e ndryshme që të mos kthehet, sepse është serb.

48. Ai pohon se uzurpatorët janë të favorizuar nga policia e Kosovës dhe gjykatat dhe se policia e Kosovës nuk ka reaguar në mënyrë të duhur ndaj ankesës së tij.
49. Në një parashtrim tjetër të datës 16 tetor, ankuesi deklaroi se R.Q. ka gënjyer lidhur me etninë e tij dhe se në të vërtetë ai është shqiptar e jo goran.

V. Vlerësimi i Panelit

50. Paneli thekson se e drejta në pronë është çështje shumë e ndërlikuar dhe prek të gjitha komunitetet në Kosovë, e që ka rezultuar në dhjetëra mijëra kërkesa për pronat e dëmtuara ose të uzurpuara. Paneli gjithashtu merr parasysh kapacitetet e misionit ndërkombëtar, siç është EULEX-i, i cili ka burime të kufizuara në dispozicion të tij në trajtimin e ankesave.

Njohja e EULEX-it me lëndën

51. Paneli vë në dukje parashtrësën e EULEX-it se nuk ka qenë në gjendje për të konfirmuar secilin regjistrim të ankesës në vitin 2010. Ankuesi ka paraqitur kopjen e korrespondencës së tij me EULEX-in, të dërguar nga llogaritë e ndryshme të postës elektronike të EULEX-it, duke përfshirë llogarinë zyrtare të EULEX-it, për pyetje të përgjithshme, e cila në mënyrë të qartë tregon se EULEX-i ka qenë në dijeni rreth çështjes nga nëntori i vitit 2009 e tutje. Në fund të vitit 2009 dhe në janar 2010, ankuesi ishte në komunikim me një zyrtar politik dhe raportues të EULEX-it dhe më pas, gjatë vitit 2012, me bashkërenduesin e EULEX-it për të Drejtat Pronësore. Paneli konstaton se dokumentacioni i paraqitur tregon se EULEX-i, së paku në vitin 2009 dhe 2010, nuk ka shfrytëzuar ndonjë sistem të duhur për regjistrimin e ankesave.
52. Paneli nuk mund të mos theksojë se në bazë të informatave në dispozicion, duket se pas kontaktit të parë të ankuesit me EULEX-in, kjo ka marrë dy vite e nëntë muaj për prokurorët e EULEX-it që të jenë në dijeni rreth kësaj lënde. Në të njëjtën kohë është argumentuar para trupit gjykues se prokurorët e EULEX-it nuk ishin dhe ende nuk janë në posedim të informacionit të nevojshëm lidhur me këtë lëndë (krahasoni par. 42 më lartë).

Parashtrësja e EULEX-i lidhur me mungesën e juridiksionit

53. EULEX ka pohuar më 30 shtator 2014 se *“në këtë rast të veçantë, prokurorët e EULEX-it nuk kanë qenë të informuar lidhur me rastin pasi që ajo bie jashtë mandatit të tyre dhe korrespondenca e ankuesit me bashkërenduesin e EULEX-it për të Drejtat Pronësore nuk ka qenë e dërguar saktësisht për prokurorët e EULEX-it”*.
54. Së pari, nga të dhënat në dispozicion të Panelit, nuk është e mundur të përcaktohet *prima facie* dhe *ex-post*, se rasti në mënyrë të qartë

nuk përbën ndonjë krim të motivuar në bazë të urrejtjes dhe prandaj ajo bie jashtë mandatit të EULEX-it, në veçanti në lidhje me mosveprimin e dyshuar të autoriteteve të Kosovës. Së dyti, sipas mendimit të Panelit është pikërisht mungesa e informacionit të dhënë për prokurorët e EULEX-it dhe rrethanat në të cilat çështja përfundimisht kishte ardhur në vëmendjen e prokurorëve të EULEX-it që shkakton shqetësim.

55. Paneli thekson se në rrethanat e çështjes në fjalë nuk konsideron se është detyrë e tij për të vlerësuar bazueshmërinë e një vendimi të prokurorisë nëse do ta nisë ndonjë hetim apo ta marrin atë përsipër prokurorët e EULEX-it nga prokurorët e Kosovës.
56. Megjithatë, është tejet e rëndësishme që pretendimet e diskutueshme që ofrohen nga individë duhet të regjistrohen siç duhet dhe se ato duhet të arrijnë tek prokurorët e EULEX-it, në mënyrë që ata të jenë në gjendje për të bërë një vlerësim të informuar nëse duhet ta hetojnë rastin apo jo. Mund të pritët në mënyrë të arsyeshme nga një mision me një mandat ekzekutiv që një sistem efektiv i regjistrimit dhe i komunikimit të ankesave do të funksionoj në mënyrë që të sigurohet se kërkesat dhe ankesat që përfshijnë akuzat për shkelje të të drejtave që vijnë në vëmendje e tij dhe të cilat mund të cenojnë ushtrimin e mandatit ekzekutiv të Misionit të paktën të jenë të regjistruara dhe të shënuara siç duhet dhe në kohën e duhur, të shqyrtohen nga strukturat përkatëse në kuadër të EULEX-it, në veçanti nga prokurorët e EULEX-it. Në mënyrë të qartë kjo nuk ka ndodhur në këtë rast.

EULEX-i dhe mjetet korrigjuese në kuadër të sistemit juridik të Kosovës

57. Parashtrësa e EULEX-it se *“një interpretim i arsyeshëm në përputhje me mandatin e EULEX-it për ndihmë ndaj institucioneve të Kosovës për sundimin e ligjit është se kompensimi duhet të kërkohet në kuadër të sistemit ligjor të Kosovës duke lejuar që të funksionojnë mjetet dhe mekanizmat në dispozicion në kuadrin e tij ligjor”*, nuk arrin të bindë Panelin se për periudhën 2009-2013 ankesa saktësisht ankohet se mjetet juridike të sistemit ligjor të Kosovës nuk kanë arritur ta trajtojnë ankesën së tij në mënyrë të duhur.

Neni 13 i KEDNj-së

58. Vlerësimi i Panelit përqendrohet vetëm në detyrimin e EULEX-it për të regjistruar dhe për të bërë një vlerësim fillestar të ankesave të tilla të të drejtave të njeriut që vijnë në vëmendjen e tij, të cilat ndoshta mund të thuhet se ndikojnë në ushtrimin e mandatit të tij ekzekutiv. Kjo nuk ka ndodhur në rastin e tanishëm. Ndërsa EULEX-i përgëzon veprimet e ndërmarra nga ana e bashkërenduesit të EULEX-it për të Drejtat Pronësore, po ashtu thekson se ato nuk përbëjnë ndonjë mjet efektiv dhe nuk zëvendësojnë vlerësimin e plotë të prokurorëve të EULEX-it, sidomos pasi që bashkërenduesi i EULEX-it për të Drejtat Pronësore ka kryesisht një rol bashkërendues, e jo rol ekzekutiv.

59. Fakti se mekanizmat gjyqësore në Kosovë më në fund kanë funksionuar, e të cilat kanë çuar në dënimin e uzurpatorit dhe kthimin e pronës së ankuesve nuk e shfajësojnë EULEX-in Kosovë nga detyrimet e veta, veçanërisht nga detyrimi i tij për të regjistruar me zell dhe nga ana tjetër sipas rregullit të regjistrohen siç duhet ankesat e sjella zyrtarisht dhe të komunikohen ato në organet kompetente brenda misionit. Në rastin konkret dështimi për të bërë këtë ka pamundësuar vlerësimin e lëndës me kohë nga ana e EULEX-it.
60. Dështimi i EULEX-it në atë kohë për të funksionalizuar një sistem të besueshëm të regjistrimit të ankesave që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave ka rezultuar që lënda e ankuesit të mbetet pezull për një periudhë prej afro dy vite e nëntë muajsh. Gjatë kësaj periudhe, EULEX-i nuk e ka kryer mandatin e tij me zell lidhur me atë ankesë. Fakti se autoritetet e Kosovës gjithashtu ishin kompetent në lidhje me këtë çështje nuk e shkarkon EULEX-in nga obligimet e veta për të vepruar në çdo kohë në një mënyrë që është në përputhje me standardet minimale të të drejtave të njeriut.
61. Bazuar në ato më sipër, Paneli konkludon se ka pasur shkelje në bazë të nenit 13 të Konventës.
62. Duke pasur parasysh gjetjet në përputhje me nenin 13, Paneli konsideron se nuk është e nevojshme të shqyrtohet ankesa sipas nenit 14 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës.
63. Uzurpimi i dyshuar i mëvonshëm i banesës së ankuesit në korrik të vitit 2014 si dhe ankesat e mëvonshme të ankuesit ndaj autoriteteve të Kosovës dhe EULEX-it i janë nënshtruar procedurave të ndryshme nga ato që janë vlerësuar në këtë rast dhe në këtë mënyrë nuk janë pjesë e vlerësimit të Panelit.

PËR KËTO ARSYE, PANELI ME SHUMICË

Konstaton se ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës;

Konstaton se nuk është e nevojshme të shqyrtohet lënda sipas neni 14 të Konventës;

Konstaton se nuk është e nevojshme të shqyrtohet lënda sipas nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës;

Prandaj, Paneli e gjen të përshtatshme në bazë të gjetjeve të tij të mësipërme të fakteve dhe ligjit të bëjë rekomandimet e mëposhtme për ShM-në sipas rregullit 34 të rregullores së vet të punës:

Të sigurohet që regjistrimet ekzistuese dhe procedurat fillestare të vlerësimit për ankesat që parashtrohen në EULEX, në atë masë sa ato ndoshta mund të prekin ushtrimin e mandatit ekzekutiv të misionit,

të vlerësohen nga stafi me ekspertizë ligjore si dhe ekspertizë të të drejtave të njeriut dhe si pasojë t'i komunikohen njësive përkatëse.

ShM ftohet të informoj Panelin rreth masave që i ka ndërmarrë në lidhje me vendimin e sotshëm deri më 31 dhjetor 2014.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda Mierzewska
Kryesuese